

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN:

Industritë prodhuese të makinerive dhe pajisjeve
ID 10.4 “Riparimi dhe mirembajtja e makinerive dhe pajisjeve motorike dhe
motocikletave nqs nuk jane permendur dikur tjeter ne kete shtojce”

Sipas shtojcës 1 të Ligjit 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, të ndryshuar”)



SUBJEKTI: “GARANT AUTO” Sh.p.k.

NIPT L72030028U

VENDNDODHJA: Tirane, Njesia Administrative
Kashar, Aut TR-DR, Rruga sekondare Km. 1, Zona
Kadastrale 2679, Numer Pasurie 166/77.

1. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Shoqëria " GARANT AUTO " Sh.p.k. me NIPT L72030028U, administrator **Roland Jarani**, është një subjekt i regjistruar në QKB dhe zhvillon aktivitetin e tij ekonomik në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën Riparimi I impianteve elektrike dhe ushqimit të automobilitave

Qëllimi i këtij subjekti ka qenë dhe mbetet përmbushja e kërkesave të cilësive dhe përndiqet dhe zbatohet me rigorozitet menaxhimi i cilësive në të gjitha hallkat e saj.

Subjekti ka siguruar staf dhe pajisje profesionale për zhvillimin e këtij aktiviteti.

Subjekti do të aplikojë për leje mjedisi Tip B

Industritë prodhuese të makinerive dhe pajisjeve

ID 10.4 "Riparimi dhe mirembajtja e makinerive dhe pajisjeve motorike dhe motocikletave nqs nuk janë përmendur dikur tjetër në këtë shtojcë"

Referuar shtojcës 1 të ligjit 52/2020 "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10448, DATË 14.7.2011, "PËR LEJET E MJEDISIT", TË NDRYSHUAR.

2. OBJEKTIVAT E AKTIVITETIT:

- ❖ Objektivi i parë i këtij aktiviteti do të jetë të identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore të kësaj instalime të cilat janë:
 - Emetimet në ajër dhe zhurmat;
 - Ndikimi në florë/faunë;
 - Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti i punetoreve;
 - Ndikime social-ekonomike;
 - Ndikim në cilësinë e jetesës në qendrat e banuara;
 - Ndikim në rritjen e trafikut rrugor;
 - Ndikim në peizazhin e zonës;


- ❖ Objektivi i dytë i këtij aktiviteti është gjetja e alternativave që janë më miqësore me mjedisin.

3. VENDODHJA E AKTIVITETIT

Vendi ne te cilin do te zhvillohet aktiviteti *Servis makinash* ndodhet ne adresen: **Tirane Kashar Njesia Administrative Kashar, Aut TR-DR, Rruga sekondare Km. 1, Zona Kadastrale 2679, Numer Pasurie 166/77.**

Vendosja e ketij instalimi ne kete zone eshte e pershtatshme per zhvillimin e ketij aktiviteti pasi zona nuk ka objekte apo vepra hidroenergjetike dhe nuk shkaktohet shqetesim per zonat e banuara te ndodhura prane vendit te ushtrimit te veprimtarise se tij.

"GARANT AUTO" SH.P.K.



Nr	X	Y
1.	4397463.89	4579696.77

4. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

ID 10.4 “Riparimi dhe mirembajtja e makinerive dhe pajisjeve motorike dhe motocikletave nqs nuk jane permendur diku tjeter ne kete shtojce”

Ne kete pike servisi, proceset e punes do kryhen sipas nje radhe te caktuar. Makina, motori apo mjete tjeter motorik qe do te kontrollohet, i nenshtrohet disa kontrolleve nga ana e xhenerikeve te punesuar ne kete subjekt, duke filluar qe nga:

- Kontrolli Vizual (kontrolli fizik) me sy.

Sisteme dhe pjesë që kontrollohen vizualisht në automjetet e ardhura ne kete servis janë:

- Sistemi i ndriçimit dhe sinjalistikës së jashtme,
- Gjendja e të gjitha gomave,
- Kroskoti i automjetit dhe funksionimi i tij,
- Fshirëset dhe larëset e xhamave,
- Sistemi elektrik,
- Të gjithë elementet që lidhen me sistemin e frenimit (pedalet, levat, tubat etj.)
- Të gjithë elementet që lidhen me sistemin e drejtimit (nyjet, gominat etj.)
- Funksionaliteti dhe siguria e dyerve, dritareve dhe pasqyrave,
- Ndenjëset dhe funksionimi i rripave të sigurimit,
- Gjendja e shasisë së automjetit,
- Konsumim jo i rregullt i pneumatikëve,
- Kauçuki i pastrueses së xhamit te dëmtuar.
- Xhamat e fenereve dhe të dritave të dëmtuara.
- Pasqyrat e lira.
- Antena e këputur.
- Rrjedhje në motor.
- Rrjedhje në sistemin e shkarkimit
- Pllakat e frenave të konsumuara
- Aksesorët që mungojnë ose janë të dëmtuar.
- Rrota rezervë që mungon.
- Dëmtime të karrocërisë që klienti nuk dëshiron ti riparojë.

Foto te aktivitetit



Disa nga proceset e mirembajtjes qe kjo pike servisi ofron jane:

- Zëvendësimi i vajit te motorrit dhe filtrit të vajit, të filtrave të karburantit, filtrit të ajrit dhe filtrit të kabinës ne bazë te kilometrave te pershkruara nga automjeti dhe percaktimi I ndërrimit të rradhes.
- Testimi dhe zevendesimi i vajit te frenave, plotesimi i nivelit të depozites së vajit të frenimit.
- Kontrolli i sistemit të frenimit, zëvendësimi i ferrotave dhe disqeve te konsumuara, regjistrimi i frenave te këmbës dhe të dores.
- Kontrolli i sistemit të ndezjes dhe plotesimi i nivelit të elektrolitit ne akumulatorin e motorit, zëvendësimi i kandleve ne automjetet me benzine dhe gaz ne bazë të kilometrave të pershkruara.
- Kontrolli i presionit te ajrit të gomave dhe rregullimi i ketij presioni ne nivelin e rekomanduar nga xheneriku.
- Pergatitja e antifrizes ne parametrat e duhur ne sistemin ftohes te motorit.
- Kontrolli i sistemit të kondicionimit të ajrit dhe zëvendësimi i gazit ftohes pas testimit të tij.
- Vendosja e sinjalizuesve dhe ndricuesve te demtuar dhe kontroll i detajuar i sistemit te sinjalizim-ndricimit.
- Kontrolli i kutisë së shpejtësisë dhe i diferencialit për nivelin e vajit dhe plotësimi i tij në raste nevojë.

5. IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMI I SHKARKIMEVE NE MJEDIS

Mjedisi eshte gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise, e cila mund te kete impakt te drejtperdrejte, te terthorte, te rendesishem apo mesatar i pranueshem.

Nga zhvillimi I aktivitetit pritet qe te kete shkarkime minimale ne mjedis, duke iu referuar edhe natyres se tij. Disa nga shkarkimet e mundshme te ketij aktiviteti jane si me poshte vijon:

Shkarkime ne ajer- Aktiviteti do te shoqerohet me shkarkime ne ajer te gazeve dhe pluhrave nga motoret me djegie te brendshme, qe mund te gjenerohen si pasoje e mberritjes se mjeteve ne servis. Keto shkarkime do te jene lehtesisht te menaxhueshme dhe te monitorueshme sepse mjetet do te qendrojne fikur ne momentin qe do te mberrijne ne subjekt.

Shkarkime ne uje- Kjo tipologji shkarkimi do te jete prezente vetem si pjese e sherbimeve higjeno-sanitare. Per sa i perket shkarkimeve nga zhvillimi i aktivitetit, nuk do te kemi pasi keto lloj aktivitetesh nuk shoqerohen me shkarkime ne uje.

Shkarkimet ne toke- Aktiviteti qe subjekti do te zhvilloje nuk shoqerohet me shkarkime ne toke. Mbetjet e vajrave dhe cdo lloj mbetje tjeter qe mund te cenoje mjedisin do te evadohet sipas legjislacionit ne fuqi.

Mbetje:

1. Mbetje jo te rrezikshme urbane- Keto mbetje do te gjenerohen nga punonjesit e punesuar ne kete aktivitet. Per menaxhimin e ketyre mbetjeve operatori do te vendose kosha me ngjyra ne menyre qe te kryhet edhe diferencimi i tyre ne vendndodhje. Koshat do te jene me kapake te mbyllur ne menyre qe te evitohen aromat e pakendshme ne ditet kur kushtet atmosferike do te jene te papershtatshme. Keto mbetje ne fund te cdo dite pune do te depozitohen ne vendin e percatuar nga NJV.

2. Mbetje nga aktiviteti – Aktivitetin qe do te zhvilloje operatori do te shoqerohet me gjenerim te mbetjeve te vajrave si dhe mbetje bojerash apo llaqesh te perdorura ne proceset e lyerjes, te cilat do te depozitohen ne depozita hermetike dhe do te terhiqen nga operatore te licencuar. Per sa i perket riparimit pjeset e zevendesuara i rikthehen klienteve.

6. MASAT ZBUTESE DHE PARANDALUESE TE NDIKIMEVE NE MJEDIS

Toka	
Perdorimi i tokes	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Kryerja e aktivitetit brenda koordinatave te percaktuara ➤ Zbatimi i kushteve teknike dhe standarteve ➤ Pastrimi periodik I reparteve te riparimit dhe mirembajtjes, duke mbarevajtur operimin optimal te tij. ➤ Pastrimi periodik i linjes se cmontimit te mbetjeve nga motoret e makinave, duke mbarevajtur operimin optimal te tij.
Biodiversiteti	
Vegjetacioni	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Mbrojtja e bimeve ne menyre sa me te mire te mundshme rreth aktivitetit.
Cilesia e Ajrit	
Emetime ne ajer	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Mbajtja fikur e automjeteve gjate marrjes se sherbimeve ne ambjentet e servisit. ➤ Perdorimi I mjeteve mbrojtese per frymemarrjen (maska me karbon)
Mbetjet	
Mbetjet urbane	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Vendosja e kontenierëve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara dhe transportimi periodik i tyre në vendepozitim më të afërt të caktuar nga njësia vendore.
Mbetje nga procesi i punes	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Asgjesimi I mbetjeve qe vijne nga proceset e riparimit, mirembajtjes dhe cmontimit te mjeteve te transportit rrugor nga operatore te licensuar.
Zhurmat	
Niveli i zhurmave	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Respektimi I gjitha rregulloreve gjate procesit te punes. ➤ Respektimi i orarit te punes ➤ Levizje e ngadalte dhe e kujdesshme ne ambjente te aktivitetit. ➤ Vendosja e tabelave zbatimin e rregullores ne ambjentet e aktivitetit ne menyre rigoroze.
Trafiku rrugor	
Trafiku rrugor	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Mjetet te levizin brenda normave te lejuara te shpejtesise, referuar Kodit Shqiptar Rrugor.

“GARANT AUTO” SH.P.K.

Administrator

Roland Jarani

